

TË-BËRËTË

Krye 1.

- 1 Ndë kryet Perëndia bëri qiellin' edhe dhenë.
- 2 Edhe dheu ishte pa formë edhe i-shkretë; edhe *ishte* errësirë mbi faqet të pafundjesë. Edhe Fryma e Perëndisë sillej mbi faqet të ujëravet.
- 3 Edhe Perëndia tha, Letë bënetë dritë; edhe
- 4 ubë dritë. Edhe Perëndia pa dritënë se ishte e-mirë; edhe Perëndia ndau dritënë nga e-
- 5 rresira. Edhe Perëndia dritën' e quajti Ditë, edhe errësirën' e quajti Natë. Edhe ubë mbrëmje, edhe ubë mëngjes, dit' e-parë.
- 6 Edhe Perëndia tha, Letë bënetë qëndresë ndër mest të ujëravet, edhe letë ndanjë ujë-
- 7 ratë nga ujëratë. Edhe Perëndia bëri qëndresënë, edhe ndau ujëratë që ishinë përposh qëndresësë nga ujëratë që ishinë përsipërë
- 8 qëndresësë; edhe ubë kështu. Edhe Perëndia e quajti qëndresënë Qiell. Edhe ubë mbrëmje, edhe ubë mëngjes, dit' e-dytë.
- 9 Edhe Perëndia tha, Letë mblidhenë ujë-
- 10 ratë që janë përposh qiellit mbë një vënt, edhe letë duketë toka; edhe ubë kështu. Edhe Perëndia tokënë e quajti Dhe; edhe të-mbledhurit' e ujëravet e quajti Dete; edhe Perëndia pa se ishte mirë.

- 11 Edhe Perëndia tha, Letë mbinjë dheu bar të-njomë, bar që bën farë, edhe dru peme që bën pemë pas farës' së tij, të-cilit fara të jetë
- 12 nd' atë mbi dhet; edhe ubë kështu. Edhe dheu mbiu bar të-njomë, bar që bën farë pas farës' së tij, edhe dru që bën pemë, të-cilit fara ishte nd' atë, pas farës' së tij; edhe Perëndia pa se ishte mirë. Edhe ubë mbrëmje, edhe ubë mëngjes, dit' e-tretë.
- 14 Edhe Perëndia tha, Letë bënenë dritarë ndë qëndresët të qiellit, që të ndanjënë ditënë nga nata; edhe letë jenë për shënja, e për kohëra, e për dit, e për vite; Edhe letë jenë për dritarë ndë qëndresët të qiellit, që të ndritnjënë mbi dhet; edhe ubë kështu.
- 16 Edhe Perëndia bëri te dy dritarët' e-mëdhenj, dritarin' e-math, që të zotëronjë mbi ditët, edhe dritarin' e-vogëlë, që të zotëronjë mbi natët; bëri edhe yjtë. Edhe Perëndia i vuri ata ndë qëndresët të qiellit, që të ndritnjënë për mbi dhet, Edhe të zotëronjë mbi ditët, edhe mbi natët, edhe të ndanjënë dritënë nga e-rrësira; edhe Perëndia pa se ishte mirë. Edhe ubë mbrëmje, edhe ubë mëngjes, dit' e-katërtë.
- 20 Edhe Perëndia tha, Letë pjellën' ujëratë me të-tepërë gjë të-gjalla që lëvisnjënë, edhe shpes që fluturonjë në përsipërë dheut ndë qëndresët të qiellit. Edhe Perëndia bëri pishqet' e-mëdhenj, edhe çdo gjë të-gjallë që lëvis, të-cilatë puallnë ujëratë me të-tepërë,

- pas farës' s' atyre, edhe çdo shpes fluturak pas farës' s' atij; edhe Perëndia pa se ishte mirë. Edhe Perëndia i bekoj ato, dyke thënë, Shtohi e shumohi, e mbushi ujëratë ndë detet; edhe shpestë letë shumonenë mbi dhet.
- 23 Edhe ubë mbrëmje, edhe ubë mëngjes, dit' e-pesëtë.
- 24 Edhe Perëndia tha, Letë pjellë dheu shtëzë të-gjalla pas farës' s' atyre, bagëti, e shtërpinj, e shtëzë të dheut pas farës' s' atyre; edhe ubë kështu. Edhe Perëndia bëri shtëzët' e dheut pas farës' s' atyre, edhe bagëtitë pas farës' s' atyre, edhe çdo shtërpi të dheut pas farës' s' atij; Edhe Perëndia pa se ishte mirë.
- 26 Edhe Perëndia tha, Letë bëjmë njerinë mbë të-përgjajturit t' ënë, pas të-shëmbëllyerit t' ënë, edhe letë zotëronjë mbi pishqet të detit, edhe mbi shpest të qiellit, edhe mbi bagëtit, edhe mbi gjithë dhenë, edhe mbi çdo shtërpi që hiqetë barkazi mbi dhet. Edhe Perëndia bëri njerinë pas të-përgjajturit të tij, pas të-përgjajturit të Perëndisë e bëri atë; mashkull e femërë i bëri ata. Edhe Perëndia i bekoj ata; edhe Perëndia u tha atyre, Shtohi e shumohi, e mbushni dhenë, e pushtoni atë; edhe zotëroni mbi pishqet të detit, edhe mbi shpest të qiellit, edhe mbi çdo gjë të-gjallë që lëvis mbi dhet. Edhe Perëndia tha, Na tek u dhashë juve çdo bar që bën farë, i-cili

është mbi faqet të gjithë dheut, edhe çdo dru që ka ndë vetëhet të tij pemë druri që bën
30 farë; *këto* dotë jenë ndër ju për ushqim; Edhe gjithë shtezëvet të dheut, edhe gjithë shpesvet të qiellit, edhe çdo *shtërpiri* që hiqetë bar-kazi mbi dhet edhe që ka jetë ndë vetëhet të tij, u dhashë çdo bar të-njomë për ushqim; edhe ubë kështu.

31 Edhe Perëndia pa gjithë sa bëri; edhe na tek ishinë fort të-mira. Edhe ubë mbrëmje, edhe ubë mëngjes, dit' e gjashtëtë.

Krye 2.

1 Edhe umbaruanë qielli edhe dheu, edhe
2 gjithë ushtëria e atyreve. Edhe të-shtattënë ditë Perëndia kishte mbaruarë punët' e tia që bëri; edhe të-shtattënë ditë uprëjt nga gjithë
3 punët' e tia që bëri. Edhe Perëndia bekoj të-shtattënë ditë, edhe e shënjtëroj atë; sepse atë *ditë* uprëjt nga gjithë punët' e tia që krioj e bëri Perëndia.

4 Këto janë gjenealogjit' e qiellit e të dheut kur ukriuan' ata, nd' atë ditë që bëri Zoti
5 Perëndia dhen' edhe qiellinë. Edhe nukë kishte edhe bimë të fushësë mbi dhet, edhe bar të fushësë edhe nukë kishte mbirë; sepse Zoti Perëndia nukë kishte prurë shi mbi dhet,
6 edhe s' kishte njeri që të punonte dhenë. Po hipënte avull nga dheu, edhe njomte gjithë faqen' e dheut.

7 Edhe Zoti Perëndia gatoj njerinë prej balte nga dheu; edhe i fryjti ndër fyejt të hundës' s' atij frymë jete; edhe njeriu ubë *me* shpirt të-gjallë.

8 Edhe Zoti Perëndia mbolli një kopësht ndë Edemë mbë *anët* të të-lindurit të dje-
9 llit, edhe njerinë që gatoj e vuri atje. Edhe Zoti Perëndia bëri të mbinjë nga dheu çdo dru i-bukurë ndë syt edhe i-mirë për të-ngrënë, edhe drurin' e jetësë ndë mest të-kopështit, edhe drurin' e të-njohurit të së-mirës' e
10 të së-keqesë. Edhe dilte një lumë nga Edema që të ujitte kopështinë, edhe që andej
11 ndahej mbë katrë dega. Emëri i të-parit ishte Fishon; ky është' ay që qerthëllon gjithë dhen'
12 e Havillahut, ku ka ar; Edhe ari i atij vëndi është' i-mirë; atje ka vdellion edhe gur të-
13 thonjtë. Edhe emëri i të-dytit lumë ishte Gjihon; ky është' ay që qerthëllon gjithë dhen' e
14 Hushit. Edhe emëri i të-tretit lumë ishte Hiddekel*); ky është' ay që rrjeth ndë Assyri nga të-lerët' e djellit. Edhe i-katërti lumë është' Evfrati.

15 Edhe Zoti Perëndia mori njerinë, edhe e vuri ndë kopësht t' Edemësë, që t'a punonte
16 e t'a ruante. Edhe Zoti Perëndia urdhëroj njerinë, dyke thënë, Nga çdo dru i kopështit
17 munt të hash liruare; Po nga drur' i të-njohurit të së-mirës' e të së-keqesë, nukë dotë

*) Tigris.

hash nge ay: sepse atë ditë që të hasi nga ay pa fjalë dotë vdesç.

- 18 Edhe Zoti Perëndia tha, Nuk' është mirë të jetë njeri... vetëmë; dot, i bënji ati një ndih-
- 19 mës posi atë. Edhe Zoti Perëndia gatoj prej dheut gjithë shtëzët' e fushësë, edhe gjithë shpest' e qiellit; edhe i pruri te njeriu që të shihte qush dot' i quante ato; edhe ate emërë që t'i vinte njeriu çdo gjëje së-gjallë,
- 20 këtë emërë të kishte. Edhe njeriu u vuri emëra gjithë bagëtitvet, e shpaset të qiellit, e gjithë shtëzëvet të fushësë; po për njerinë nukë
- 21 gjëndej ndihmës posi ay. Edhe Zoti Perëndia vuri Adamnë mbë gjumë të-rënuë, edhe fjeiti; edhe mori një nga brinjët' e atij, edhe
- 22 ja mbylli vëndinë me mish. Edhe brinjënë që mori Zoti Perëndia nga Adami e bëri grua,
- 23 edhe j'a pruri Adamit. Edhe Adami tha, Këjo tashi është' ashtë nga eshtërat' e mia, edhe mish nga mishi im; këjo dotë quhetë grua,
- 24 sepse këjo është marrë nga burri. Përandaj njeriu dotë lërë t'an' e t'emënë, edhe dotë ngjitetë pas gruas' së tij; edhe dotë jenë një
- 25 mish. Edhe ishinë lakuriq që të dy, Adami edhe gruaja e atij, edhe s' kishinë turp.

Krye 3.

- 1 Edhe gjarpëri ishte më dinak se gjithë shtëzët' e fushësë që kishte bërë Zoti Perëndia; edhe *gjarpëri* i tha gruasë, A me të-vërtetë

- tha Perëndia, Mos hani nga çdo dru i kopështit? Edhe gruaja i tha gjarpërit, Nga pemët' e drurëvet të kopështit munt të hamë;
- 3 Po sa për pemën' e drurit, që është ndë mest të kopështit, Perëndia tha, Nukë dotë hani nga ay, as dot' i piqni atij, që të mos vdisni.
- 4 Edhe gjarpëri i tha gruasë, Me të-vërtetë nukë dotë vdisni; Po Perëndia e di, se atë ditë që të hani nga ay dot' u hapenë juve sytë, edhe dotë jini posi perëndira, dyke njohurë të-mirën' e të keqenë.
- 6 Edhe gruaja kur pa, se druri ishte i-mirë për të-ngrënë, edhe se ishte i-pëlqyerë ndë syt, edhe se ishte një dru i-dëshëruarshim, se ep mënt, mori prej pemës' s' atij, edhe hëngri; edhe i dha edhe burrit të saj bashkë
- 7 me vetëhen' e saj, edhe ay hëngri. Atëhere uhapnë sytë atyre që të dyve; edhe e njohnë se ishinë lakuriq; edhe qepnë bashkë fletë fiku, edhe i bënë vetëhes' së tyre përparje.
- 8 Edhe dëgjuanë zën' e Zotit Perëndisë, tek po ecënte ndë kopësht mbë zëmërë-herë; edhe Adami edhe gruaja e atij ufshehnë prej faqes' së Zotit Perëndisë ndër mest të drurëvet të kopështit. Edhe Zoti Perëndia thirri
- 10 Adamnë, edhe i tha, Ku je? Edhe ay tha, Dëgjoja zënë t'ënt ndë kopësht, edhe ufrikësuashë, sepse jam lakuriq; edhe ufshehçë.
- 11 Edhe *Perëndia* tha, Kush të dëfteu se je lakuriq? Mos hëngre prej drurit që të pata

- 12 urdhëruarë të mos hash prej atij? Edhe Adami tha, Gruaja që më dhe që të jetë bashkë me mua, ajo më dha nga druri, edhe hëngra.
- 13 Edhe Zoti Perëndia i tha gruasë, Ç' është këjo që bëre? Edhe gruaja tha, Gjarpëri më qën-jeu, edhe hëngra.
- 14 Edhe Zoti Perëndia i tha gjarpërit, Me-qënë-që bëre këtë, dotë jesh i-mallëkuarë ndër mest të gjithë bagëtivet, e ndër mest të gjithë shtëzëvet të fushësë; mbi barkunë t'ënt dotë ecënjç, edhe dhe dotë hash gjithë
- 15 ditt' e jetësë s' atë; Edhe armiqësi dotë vë ndër mest teje edhe të gruasë, edhe ndër mest të farësë s' ate edhe të farës' s' asaj; ajo dotë të shtypnjë kryetë, edhe ti dot' i çponjç
- 16 thëmbrenë. Edhe gruasë i tha, Dotë shumonj tepërë hidhërimet' e tu edhe të-dhëmburat' e të-pjellit t'ënt; me hidhërimë dotë pjellç fëmijë; edhe dëshërimi yt dotë jetë mbë burrinë t'ënt, edhe ay dotë të urdhëronjë ty.
- 17 Edhe Adamit i tha, Me-qënë-që i dëgjove zërit të gruasë s' ate, edhe hëngre nga druri, për të-cilinë të urdhërova, dyke thënë, Nukë dotë hash prej atij, i-mallëkuarë dotë jetë dheu për tynë; me mundim dotë hash prej atij gjithë
- 18 ditt' e jetësë s' ate; Edhe dotë mbinjë për ty gjëmba edhe driza; edhe dotë hash barin'
- 19 e arësë; Me djersë të faqesë s' ate dotë hash bukënë, gjersa të kthenesh ndë dhet, prej të

cilit umore; sepse dhe je, edhe ndë dhe dotë kthenesh.

- 20 Edhe Adami j'a vuri emërinë gruas' së tij Evë,*) sepse ajo ishte e ëm' e gjithë të-gjallëvet.
- 21 Edhe Zoti Perëndia i bëri Adamit edhe gruas' s' atij rroba të-lëkurëta, edhe i veshi
- 22 ata. Edhe Zoti Perëndia tha, Na njeriu tek ubë posi një prej nesh, për të njohurë të-mirën' e të-keqenë; edhe tashi që të mos ndenjë dorën' e tij, e të marrë nga drur' i jetësë, e të hajë, e të rronjë për gjithë jetënë.
- 23 Përandaj Perëndia e nxori atë jashtë kopështit t' Edemësë, për të punuarë dhenë, prej
- 24 të-cilit ishte marrë. Kështu e dëboj njerinë; edhe ndë kopështit të Edemësë nga të-lindurit' e djellit vuri Qerubimetë, edhe kordhën' e-flakëtë që kthenej nga të-gjihtë anëtë, që të ruaninë udhën' e drurit të jetësë.

Krye 4.

- 1 Edhe Adami njohu Evënë, gruan' e tij; edhe ajo umbars, edhe polli Kaininë; edhe tha,
- 2 Fitova një njeri me *naïhmën'* e Zotit. Edhe ajo polli përsëri të vëllan' e atij Abel. Edhe Abeli ishte bari dhësh, po Kaini ishte bujk
- 3 Edhe pas ca kohë Kaini i pruri Zotit dhuratë nga pemët' e dheut. Edhe Abeli, pruri edhe ay nga të-lashiat' e dhënet të tij, edhe

*) jetë.

4 nga dhjami i atyreve. Edhe Zoti vështroj me sy të-mirë mbë Abelin' e mbë dhuratën' e atij;

5 Po mbë Kainin' e mbë dhuratën' e atij nukë vështroj. Edhe Kaini uzëmërua fort, edhe i

6 uvrërua fytyra. Edhe Zoti i tha Kainit, Përse

7 uzëmërove? edhe përse t' uvrërua fytyra? Ndë bëfsh mirë, a nukë dotë pritesh *me të-mirë?* edhe ndë mos bëfsh mirë, faji dergjetë ndë derët. Edhe mbë ty dotë jetë dëshërimi i atij, edhe i dotë zotëronjç mbi atë.

8 Edhe Kaini foli me Abelinë, të-vëllan' e tij. Edhe tek po ishinë ndë fushët, Kaini ungrit kundrë Abelit, vëllajt të tij, edhe e vrau.

9 Edhe Zoti i tha Kainit, Ku është Abeli, yt vëlla? Edhe ay tha, Nukë di; mos jam unë

10 ruajtësi i t'im vëllaj? Edhe *Zoti* tha, Ç' bëre? zëri i gjakut të t'yt vëllaj thërret mbë mua

11 prej dheut. Edhe tashi dotë jesh i-mallëkuarë nga dheu që hapi gojën' e tij për të priturë gjakun' e t'yt vëllaj nga dora jote; Kur të pnonjç dhenë paskëtaj, s' të ka për të dhënë fuqin' e tij: dotë ikënjç e dotë sillesh

13 andej e këtej mbi dhet. Edhe Kaini i tha Zotit, Mundimi im është më i-math se sa

14 munt t'a duronj. Na tek po më ndoqe sot nga faqeja e dheut; edhe nga faqeja jote dotë fshihem, edhe dotë ikënj edhe dotë sillem andej e këtej mbi dhet; edhe kushdo

15 që të më gjenjë dotë më vrasë. Edhe Zoti i tha atij, Përandaj kushdo që të vrasë Kaininë,

i shtatëmëzuarë çpagim dotë merrëtë prej atij. Edhe Zoti i vuri shënjë Kainit, që kushdo

16 që t'a gjenjë të mos e vrasë atë. Edhe Kaini dolli që prej faqes' së Zotit, edhe ndënji ndë dhet të Nodhit, nga ana që lint dielli ndë Edemë.

17 Edhe Kaini njohu gruan' e tij, edhe ajo umbars, edhe polli Enohunë; edhe ndërtoj një qytet, edhe emërin' e qytetit e quajti Enoh,

18 mb'emërit të të birt. Edhe Enohut i lindi Iradi; edhe Iradit i lindi Mehujaili; edhe Mehujailit i lindi Methushaili; edhe Methushailit i lindi Llamëhu.

19 Edhe Llamëhu mori dy gra për vetëhen' e tij; i njërësë emëri ishte Adahë, edhe emër' 20 i tjatrësë ishte Sillahë. Edhe Adaha polli Jaballinë; ky ishte i at' i atyreve që rrinë ndë

21 tända edhe *mbajnë* baqëti. Edhe emëri i të vëllajt ishte Juball; ky ishte i at' i atyreve që i

22 bjenë qitharës' e fyellit. Edhe sa për Sillahënë, ajo polli Thuball-kainë, ndërtonjësin' e çdo orëndie presëse prej rame e prej hekuri; edhe e motëra e Thuball-kainit ishte Na-

23 amaha. Edhe Llamëhu u tha gravet të ti:
 Adahë edhe Sillahë, dëgjoni zënë t'im;
 Gra të Llamëhut, mba-u-ni vesh fjalëvet të mia;
 Sepse vrava burrë që t'a kem plagë,
 Edhe djalosh që t'a kem frushkullë;

- 24 Ndë Kainit *ligësia* dot' i çpaguhetë shtatë herë,
Pa fjatë Llamehut shtatë-dhjet' e shtatë herë.
- 25 Edhe Adami njohu përsëri gruan' e tij, edhe ajo polli djalë, edhe j'a vuri emërinë Sith; sepse, *tha*, Perëndia më dha një tjetërë farë
- 26 ndë vëntt të Abelit që vrau Kaini. Gjithashtu edhe Sithit i lindi djalë; edhe j'a vuri emërinë Enos. Atëhere zunë të thërresënë mb' emërin' e Zotit.

Krye 5

- 1 Këjo ësthë vivlia e gjenealogjivet t' Adamit. Atë ditë që bëri Perëndia njerinë, pas
- 2 shëmbellesës' së Perëndisë e bëri; Mashkull e femërë i bëri ata; edhe i bekoj ata, edhe e quajti emërin' e atyre Adam, atë ditë që i bëri ata.
- 3 Edhe Adami rroj një qint e tri-dhjetë vjet, edhe i lindi *djalë* mbë shëmbëllimt të tij, pas të-përgjajturit të tij, edhe j'a vuri emërinë Sith. Edhe ditt' e Adamit, passi i lindi Sithi, ishinë tetë qint vjet; edhe i lintnë
- 4 bij e bija. Edhe gjithë ditt' e Adamit që rroj ishinë nëntë qint e tri-dhjetë vjet; edhe vdiq.
- 5
- 6 Edhe Sithi rroj një qint e pesë vjet, edhe
- 7 i lindi Enosi. Edhe Sithi rroj, passi i lindi Enosi, tetë qint e shtatë vjet, edhe i lintnë

- 8 bij e bija. Edhe gjithë ditt' e Sithit ishinë nëntë qint e dy-mbë-dhjetë vjet; edhe vdiq.
- 9 Edhe Enosi rroj nëntë-dhjetë vjet, edhe
- 10 i lindi Kainani. Edhe Enosi rroj, passi i lindi Kainani, tetë-qint e pesë-mbë-dhjetë vjet,
- 11 edhe i lintnë bij e bija. Edhe gjithë ditt' e Enosit ishinë nëntë qint e pesë vjet; edhe vdiq.
- 12 Edhe Kainani rroj shtatë-dhjetë vjet, edhe
- 13 i lindi Mahallaleili. Edhe Kainani rroj, passi i lindi Mahallaleili, tetë qint e dyzet vjet,
- 14 edhe i lintnë bij e bija. Edhe gjithë ditt' e Kainanit ishinë nëntë qint e dhjetë vjet; edhe vdiq.
- 15 Edhe Mahallaleili rroj gjashtë dhjet' e pesë
- 16 së vjet, edhe i lindi Jaredi. Edhe Mahallaleili rroj, passi i lindi Jaredi, tetë qint e tri-dhjetë
- 17 të vjet, edhe i lintnë bij e bija. Edhe gjithë ditt' e Mahallaleilit ishinë tetë qint e nëntë-dhjet' e pesë vjet; edhe vdiq.
- 18 Edhe Jaredi rroj një qint e gjashtë-dhjet' e dy
- 19 e dy vjet, edhe i lindi Enohu. Edhe Jaredi rroj, passi i lindi Enohu, tetë qint vjet, edhe
- 20 i lintnë bij e bija. Edhe gjithë ditt' e Jaredit ishinë nëntë qint e gjashtë-dhjet' e dy vjet; edhe vdiq.
- 21 Edhe Enohu rroj gjashtë-dhjet' e pesë vjet,
- 22 edhe i lindi Methusalla. Edhe Enohu eci me Perëndinë, passi i lindi Methusalla, tre qint
- 23 vjet, edhe i lintnë bij e bija. Edhe gjithë ditt' e Enohut ishinë tre qint e gjashtë-dhjet' e

- 24 pesë vjet. Edhe Enohu eci me Perëndinë, edhe nuk' ugjënt më; sepse Perëndia e mori.
- 25 Edhe Methusalla rroj një qint e tetë-dhjet'
- 26 e shtatë vjet, edhe i lindi Llamehu. Edhe Methusalla rroj, passi i lindi Llamehu, shtatë
- 27 qint e tetë-dhjet' e dy vjet, edhe i lintnë bij e bija. Edhe gjithë ditt' e Methusallësë ishinë nëntë qint e gjashtë-dhjet' e nëntë vjet; edhe vdiq.
- 28 Edhe Llamehu rroj një qint e tetë-dhjet'
- 29 e dy vjet, edhe i lindi një djalë; edhe j' a vuri emërinë Noe, dyke thënë, Ky dotë na prënjë nga puna jonë edhe nga mundimi i duarvet t' ona, për punë të dheut që mallë-
- 30 koj Zoti. Edhe Llamehu rroj, passi i lindi Noeja, pesë qint e nëntë-dhjet' e pesë vjet,
- 31 edhe i lintnë bij e bija. Edhe gjithë ditt' e Llamehut ishinë shtatë qint e shtatë-dhjet' e shtatë vjet; edhe vdiq.
- 32 Edhe Noeja ishte pesë qint vjeç ndë mosshë; edhe Noesë i lindi Shimi, e Hami, e Jafethi.

Krye 6

- 1 Edhe kur zunë njerëzitë të shumonenë mbi faqet të dheut, edhe bija u lintnë atyre,
- 2 Të bijt' e Perëndisë, kur panë të bijat' e njerëzet se ishinë të-bukura, muarrë gra për vetëhen' e tyre nga gjith' ato që sgjodhë.
- 3 Edhe Zoti tha, Nukë dotë luftonjë fryma ime

- gjithënjë me njerinë, sepse është mish; ditt' e ati dotë jenë edhe një qint e njëzet vjet.
- 4 Nd' ato dit ishinë gjigandëtë mbi dhet, edhe pastaj, passi hynë të bijt' e Perëndisë ndër të bijat të njerëzet, edhe ato u puallnë djem atyre, ata ishinë të-fortëtë burra, të-cilëtë që moti ishinë burra me emërë.
- 5 Edhe Zoti pa se ligësia e njeriut ishte e-madhe mbi dhet, edhe se gjithë qëllime' e mendimevet të zëmërës' s' atij ishinë gjithënjë
- 6 vetëmë të-këqia. Edhe Zoti upendua që bëri njerinë mbi dhet, edhe uhidhërua ndë zëmë-
- 7 rët të tij. Edhe Zoti tha, Dotë shuanj njerinë që bëra prej faqes' së dheut, që nga njeriu e gjer mbë bagëti, e shtërpi, e shpes qi-
- 8 elli; sepse upendova që bëra ata. Po Noeja gjeti hir përpara Zotit.
- 9 Këto janë gjenealogjit' e Noesë. Noeja, ishte njeri i-drejtë, i-sosurë ndë kohët të ti;
- 10 Noeja eci me Perëndinë. Edhe Noesë i lintnë tre djem, Shimi, Hami e Jafethi.
- 11 Edhe dheu uvduar përpara Zotit, edhe
- 12 umbush dheu me paudhëri. Edhe Perëndia pa dhenë, edhe na tek ishte vdjerrë; sepse çdo mish kishte vdjerrë udhën' e tij mbi dhet.
- 13 Edhe Perëndia i tha Noesë, Fundi i çdo mishi erdhi përpara meje, sepse dheu umbush me paudhëri prej atyre; edhe na tek.
- 14 dotë shuanj ata bashkë me dhenë. Bëj për vetëhenë t' ende një arkë prej drush goferi,

dhomëra të bënç nd' arkët, edhe t' e lyejç
 15 atë me pisë përbrënda e përjashta. Edhe
 kështu t' a bënç atë; të-gjatët' e arkëse të
 jetë tre qint kut, të-gjerët' e asaj pesë-dhje-
 të kut, edhe të-lartët' e asaj tri-dhjetë kut.
 16 Të bënç një vënt për dritë nd' arkët, edhe
 t' a ngresh një kut siprazi; edhe t' ja lësh
 derën' arkësë prej ijash; me pat të-po-
 shtërë, të-mesm, edhe të-tretë t' a bënç atë.
 17 Edhe unë vetë tek po bje përmytjen' e u-
 jëravet mbi dhet, që të vdjer ndënë qiellt
 çdo mish, që ka frymë jete ndë vetëhet të
 18 tij; çdo që është ndë dhet dotë vdesë. Po
 me ty dotë vë dhiatënë t' ime; edhe dotë
 hynç nd' arkët, ti, edhe bijt' e tu, edhe gru-
 aja jote, edhe grat' e bijvet të tu bashkë me
 19 ty. Edhe nga çdo gjë e-gjallë prej çdo mi-
 shi, nga dy nga të-gjitha, dotë kllaç brënda
 nd' arkët, që t' i ruanç të-gjalla bashkë me
 20 ty; dotë jenë mashkull e femërë. Nga shpes-
 të pas farës' s' atyre, e nga bagëtitë pas
 farës' s' atyre, nga dy prej çdo fare dotë
 21 hynjënë te ti, që t' u ruanç jetënë. Edhe ti
 merr për vetëhenë l' ende prej çdo ushqimi
 që hahetë, edhe t' a mblethç përënë teje; edhe
 të jetë për ushqim për ty, edhe për ato.
 22 Edhe Noeja bëri gjithë, sikundrë e ur-
 dhëroj Perëndia; ashtu bëri.

Krye 7.

1 Edhe Zoti i tha Noesë, Hyrë nd' arkët ti,
 edhe gjithë shtëpia jote; sepse ty të pashë
 2 të-drejtë përpara meje ndë këtë bres. Prej
 çdo shtëze së-pastrëtë merr me vetëhenë t'
 ende shtatë e shatë, mashkullin' e femërën' e
 asaj; edhe prej shtëzëvet që s' janë të-pa-
 strëta nga dy, mashkullin' e femërën' e asaj;
 3 Edhe nga shpest' e qiellit shtatë e shtatë, ma-
 shkull e femërë; që të ruanç farë mbi fa-
 4 qet të gjithë dheut. Sepse edhe shtatë dit,
 edhe dotë bje shi mbi dhet dyzet dit' e dyzet
 net; edhe çdo gjë të-gjallë që kam bërë dot'a
 5 shuanj nga faqeja e dheut. Edhe Noeja bëri
 gjithë, sikundrë e urdhëroj Zoti.
 6 Edhe Noeja ishte gjashtë qint vjeç, kur
 7 ubë përmytja e ujëravet mbi dhet. Edhe hy-
 ri nd' arkët Noeja, edhe të bijt' e atij, edhe
 gruaja e atij, edhe grat' e bijvet t' ati bashkë
 me atë, për punë të ujëravet të përmytjesë.
 8 Nga shtëzët' e-pastrëta e nga shtëzëtë që s'
 janë të-pastrëta, e nga shpestë, e nga gjithë
 9 shtërpinjëtë që hiqenë barkazi mbi dhet, Dy
 nga dy hynë nd' arkët te Noeja, mashkull e
 femërë, sikundrë e urdhëroj Noenë Perëndia.
 10 Edhe pas shtatë ditsh, ujërat' e përmy-
 11 tjesë ishinë mbi dhet. Të-gjashtë qindinë vit
 të jetës' së Noesë, të-dytinë muaj, të-shtatë-
 mbë-dhjetënë ditë të muajit, atë ditë ucanë
 gjithë burimet' e abyssës' së-madhe, edhe fi-

- 12 nestrat' e qiellit uhapnë. Edhe ra shi mbi
 13 dhet dyzet dit e dyzet net. Edhe atë ditë hyri nd' arkët Noeja, edhe të bijt' e Noesë, Shimi, e Hani, e Jafethi, edhe gruaja e Noesë, edhe të tri grat' e bijvet t' atij bashkë me ata;
 14 Ata, edhe gjithë shtëzëtë pas farës' së tyre, edhe gjithë bagëtitë pas farës' së tyre, edhe gjithë shtërpintjët që hiqenë barkazi mbi dhet pas farës' së tyre, edhe gjithë shpestë pas farës' së tyre, çdo që fluturon prej çdo fare. Edhe hynë nd' arkët te Noeja, dy nga dy prej çdo
 15 mishit që ka frymë jete. Edhe ato që hynë, hynë mashkull e femërë prej çdo mishit, sikundër e urdhëroj atë Perëndia. Edhe Zoti e mbylli *arkënë* sipër' atij.
 17 Edhe ubë përmytja dyzet dit përmbi dhet; edhe ushuanë ujëratë, edhe ngritnë arkënë, edhe hipi lart përmbi dhet. Edhe po shtonëshin' ujëratë, e po shumonëshinë fort mbi dhet; edhe arka sillej mbi faqet të ujëravet. Edhe ujëratë ushtuanë fort mbi dhet; edhe umbuluanë gjithë malet' e-lartë që ishinë ndënë gjithë qiellinë. Pesë-mbë-dhjetë kut përsipërë hipnë ujëratë, edhe umbuluanë maletë.
 21 Edhe vdiq çdo mish që lëviste mbi dhet, shpes, e bagëti, e shtëzë, e gjithë shtërpintjët që hiqenë barkazi mbi tokët, e çdo njeri. Nga gjithë sa ishinë mbi tokët, gjithë sa kishinë frymë jete ndër fyejt të hundësë, vdiqnë. Edhe ushua çdo gjë e-gjallë që ishte mbi faqet të

- dheut, njeri, e bagëti, e shtërpi, e shpes të qiellit; edhe ushuanë prej dheut; edhe mbeti vetëmë Noeja, edhe sa qenë bashkë me atë nd'
 24 arkët. Edhe mbetnë ujëratë të-lartuara përmbi dhet një qint e pesë-dhjetë dit.

Krye 8.

- 1 Edhe Perëndia kujtoj Noenë, e gjithë gjët' e-gjalla, e gjithë bagëtitë që ishinë bashkë me atë nd' arkët; edhe Perëndia bëri të shkonjë një erë përmbi dhet, edhe ureshtnë ujëratë. Edhe umbyllnë burimet' e abyssësë, edhe finestrat' e qiellit, edhe pushoj shiu nga qjejtë. Edhe pa pushim po hiqeshinë ujëratë prej dheut; edhe pas një qint e pesë-dhjetë ditsh upakësuanë ujëratë. Edhe të-shtattinë muajt, mbë-të-shtatë-mbë-dhjettënë-ditë-të-muajt, arka ndënjë mbi malet të Araratit. Edhe ujëratë pa pushim po pakësonëshinë gjer mbë të-dhjettinë muajt; të-dhjettinë muajt, mbë të-parrënë ditë të muajt, uduknë majat' e malevet.
 6 Edhe ndë funtt te dyzet ditve Noeja hap i-finestrën' e arkësë që kishte bërë; Edhe lëshoj korbinë, i-cili vij e vinte, gjer sa uthanë ujëratë prej dheut. Pastaj lëshoj edhe pëllumbinë që përënë vetëhes' së tij, për të parë ndë kishinë shteruarë ujëratë prej faqes' së dheut. Po pëllumbi nukë gjeti të-prëjturë për këmbët' e tia, edhe ukthye tek ay nd' arkët; sepse ujërat' ishinë mbi faqet të gjithë dheut.

- Edhe ay ndejti dorën' e tij, edhe e zuri, edhe e kalli brënda nd' arkët përanë vetëhes' së tij.
- 10 Edhe priti edhe shtatë dit të-tjera; edhe
- 11 përsëri lëshoj pëllumbinë nga arka; Edhe pëllumbi ukthye tek ay ndajë mbrëma, edhe na tek kishte ndë gojët të ti një fletë ulliri, sërish të-këputurë; kështu Noeja e kupëtoj se
- 12 ujëratë kishinë shteruarë prej dheut. Edhe priti edhe shtatë dit të-tjera, edhe lëshoj *prapë* pëllumbinë; edhe ky nuk' ukthye më tek ay.
- 13 Edhe të-gjashtë qindin' e një vit të *Noesë*, të-parinë muaj, të-parënë ditë të muajt, ujëratë ishinë tharë prej dheut; edhe Noeja ngriti kulmin' e arkësë, edhe pa, edhe na tek
- 14 ishte tharë faq' e dheut. Edhe të-dytinë muaj, të-njëzet e shtattënë ditë të muajt dheu ishte i-thatë.
- 15 Edhe Perëndia i foli Noesë, e i tha, Dil
- 16 nga arka, ti, edhe gruaja jote, edhe bijt' e tu,
- 17 edhe grat' e bijvet të tu bashkë me ty. Nxir bashkë me ty çdo gjë të-gjallë që është bashkë me ty prej çdo mishi, shpes, e bagëti, e çdo shtërpi që hiqetë barkazi mbi dhet, e letë shamonenë mbi dhet, e letë shtonenë, e
- 18 letë bënenë plot mbi dhet. Edhe Noeja do-lli, edhe të bijt' e ati, edhe gruajt' e ati, edhe
- 19 grat' e bijvet t' ati bashkë me atë; Gjithë shtëzëtë, gjithë shtërpinjtë, e gjithë shpestë, çdo që lëvis mbi dhet, pas faravet të tyre, dualinë nga arka.

- 20 Edhe Noeja ndërtoj një therore për Zotinë; edhe mori nga çdo bagëti e-pastrëtë, edhe nga çdo shpes i-pastrëtë, edhe pruri kurban
- 21 të-gjithëdjegurë mbi theroret. Edhe Zoti mori erë të-mirë; Edhe Zoti tha ndë zëmëret të ti, S' kam për të mallëkuarë më dhenë për punë të njeriut; sepse mendimi i zëmëres' së njeriut është i-lik që nga foshnjëria e atij; as kam për të prishurë më prapë çdo
- 22 gjë të-gjallë, sikundrë bëra. Gjersa të jetë dheu, të-mbjellë e të-korrë, e të-ftohët' e të ngrohëtë, e verë e dimër, e ditë e natë, nukë kanë për të pushuarë.

Krye 9.

- 1 Edhe Perëndia bekoj Noenë, edhe të bijt' e ati, edhe u tha atyre, Shtohi, e shumohi, e
- 2 mbushni dhenë. Edhe frikë prej jush, edhe të-dridhurë prej jush, dotë jetë mbi çdo shtëzë të dheut, edhe mbi çdo shpes të qiellit; këto me çdo *gjë* që lëvis mbi dhet, edhe me gjithë pishqet' e detit openë ndë dorët t' uaj.
- 3 Çdo gjë që lëvis e rron dot' u jetë juve për ushqim; të-gjitha posi barin'e-njomë u'a
- 4 kam dhënë juve. Po mish me jetën' e ati, me
- 5 gjakun' e ati, nukë dotë hani. Edhe pa fjalë gjakunë t' uaj, të jetësë s' uaj, dot'a kërkonj; nga dora e çdo shtëze dot' a kërkonj atë; edhe nga dora e njeriut, po, nga dora e vëllajt të çdo njeriu dot'a kërkonj jetën' e nje-

- 6 riut. Kush derth gjak njeriu, prej njeriu dotë
derdhetë gjaku i atij; sepse pas shëmbëlli-
7 mit të Perëndisë e bëri *Perëndia* njerinë. Edhe
ju, shtohi, e shumohi; mbushi plot mbi dhet,
edhe shumohi mbi atë.
- 8 Edhe Perëndia i foli Noesë, edhe të bij-
9 vet t' atij bashkë me atë, e i tha, Edhe unë
na tek vë dhiatënë t' ime me ju, edhe me fa-
10 rënë t' uaj pas jush; Edhe me çdo gjë të-
gjallë që është bashkë me ju, me shpestë, me
bagëtitë, edhe me çdo shtezë të dheut, *që ja-
në bashkë* me ju; me çdo që dolli nga arka,
11 po, me çdo shtezë të dheut. Edhe dotë vë
dhiatënë t' ime me ju; asndonjë mish nukë
dotë vdirëtë më nga ujërat' e përmytjesë;
as nukë dotë hënetë më përmytje që të
prishnjë dhenë.
- 12 Edhe Perëndia tha, Këjo është shënja e
dhiatësë që po bën unë ndër mest meje edhe
juve edhe të çdo gjëje së-gjallë që është me
13 ju, për brezat' e-përjetëshme; Po vë yl-berinë
t'im ndë ret, edhe dotë jetë për shënjë dhia-
14 te ndër mest meje edhe të dheut. Edhe kur
të bje re mbi dhet, dotë duketë yl-beri ndë
15 ret, Edhe dotë kujtonj dhiatënë t' ime që bë-
ra ndër mest meje e juve e të çdo gjëje
së-gjallë prej çdo mishi; edhe ujëratë nukë
dotë jenë më për përmytje që të prishnjë-
16 në çdo mish. Edhe yl-beri dotë jetë ndë ret;
edhe dotë shikonj mbi atë, që të kujtonj

- dhiatën' e-përjetëshme ndër mest të Perëndi-
së edhe të çdo gjëje së-gjallë prej çdo mishi
17 që është mbi dhet. Edhe Perëndia i tha No-
esë, Këjo është shënja e dhiatësë që vura
ndër mest meje edhe të çdo mishi që është
mbi dhet.
- 18 Edhe të bijt' e Noesë që duallë nga arka
ishinë Shimi, e Hami, e Jafethi. Edhe Hami
17 ishte i at' i Hanaanit. Këta të tre janë të bijt'
e Noesë, edhe prej këtyre upëndanë *njerëzitë*
mbë gjithë dhenë.
- 20 Edhe Noeja zuri të bënetë bujk, edhe vu-
21 ri veshtë; Edhe piu nga vera, edhe udejt,
22 edhe usvesh lakuriq ndë tendët të tij. Edhe
Hami, i at' i Hanaanit, pa të sveshurit' e t'et,
edhe u dëfteu të dy vëllezëret të tij përjashta.
- 23 Po Shimi e Jafethi muarrë një rrobë, edhe e
vunë përmbi të dy supat' e tyre, edhe ,dyke
ecurë krahë-prapazi, mbuluanë të-sveshurit'
e atit të tyre; edhe sytë i kishinë prapa, edhe
kështu nukë panë të-sveshurit' e atit të tyre.
- 24 Edhe Noeja, si uesëllua nga vera e tij,
mori vesh se ç' i kishte bërë atij i bir' i tij
25 m'i-vogëli. Edhe tha, Qoft' i-mallëkuarë Ha-
naani; shërbëtuar i shërbëtorëvet dotë jetë të
vëllezërit' e ti.
- 26 Edhe tha, I-bekuarë qoftë Zoti, Perëndia
i Shimit; edhe Hanaani dotë jetë shërbëtori
27 i atij. Perëndia dotë sgjeronjë Jafethinë, edhe
dotë rrijë ndë tendat të Shimit; edhe Hana-
ani dotë jejë shërbëtori i atij.

28 Edhe Noeja rroj pas përmytjesë tre qint
29 e pesë-dhjetë vjet. Edhe gjithë ditt' e Noesë
ubënë nëntë qint e pesë-dhjetë vjet; edhe vdiq.

Krye 10.

- 1 Edhe këto janë gjenealogjit' e bijvet të Noesë, Shimi, Hami e Jafethi; edhe atyre u lintnë bij pas përmytjesë.
- 2 Të bijt' e Jafethit ishinë Gomori, e Magogu, e Madaiu, e Javani, e Thuballi, e Me-sehu, e Thirasi.
- 3 Edhe të bijt' e Gomerit ishinë Asqenazi, e Rifathi, e Thogarmaj.
- 4 Edhe të bijt' e Javanit ishinë Elishau, e Tharsisi, Qitimi, e Dodanimi.
- 5 Prej këtyreve undanë ujdhesat' e kombevet ndëpër vëndët të tyre, gjithë-sicili pas gjuhës' së tij; pas faravet të tyre, ndë kombet të tyre.
- 6 Edhe të bijt' e Hamit ishinë Hushi, e Misraimi, e Futhi, e Hanaani.
- 7 Edhe të bijt' e Hushit ishinë Sevahu e Habillahu, e Sabtahu, e Raamahu, e Sabtekau; edhe të bijt' e Raamahut ishinë Shebahu, e Dedani.
- 8 Edhe Hushit i lindi Nimrodi; ky zuri të jetë
9 i-fortë mbi dhet. Ay ishte një i-fortë gjahtuar përpara Zotit: përandaj thuhetë, Posi Nimro-
10 di, gjahtuar i-fortë përpara Zotit. Edhe të-nisurit' e mbretëris' s'ati qe Babillona, edhe E-

- rehu, edhe Ahadi, edhe Hallnea, ndë dhet të
11 Shenaarit. Nga ky dhe dolli nd' Assyri, edhe ndërtoj Ninevinë, edhe qytetin' e Rehovothit,
12 edhe Hallahënë, Edhe Resenënë ndër mest të Ninevisë e të Hallahësë, që është një qytet i-math.
- 13 Edhe Misraimit i lintnë Lludimët' e Anamitët' e Labimët' e Nafthuhimëtë. E Pathrusimët' e Haslluhimëtë (prej të-cilëvet duallnë Filistinëtë), edhe Hafthorimëtë.
- 15 Edhe Hanaanit i lintnë Sidoni, i-parë-linduri i tij, edhe Hethi, Edhe Jebusitetë, e Amoritëtë, e Gjergjesitetë, E Hivitetë, e Arqitëtë, e Sinitëtë, E Arvaditetë, e Semaritetë, e Hamathitetë.
- 19 Edhe paskëtaj upërndanë farat' e Hanaanitëvet. Edhe sinorët' e Hanaanitëvet ishinë që nga Sidhona, kur vete njeriu për ndë Gjerrarë, e gjer ndë Gazët, edhe kur vete ndonjë për ndë Sodhomë e Gomorrë e Adma, e Seboim, gjer ndë Llasha.
- 20 Këta janë të bijt' e Hamit, pas faravet të tyre, pas gjuhëravet të tyre, ndë vëndet të tyre, ndë kombet të tyre.
- 21 Edhe Shimit, atit të gjithë të bijvet t' Eberit, vëllajt më të-math të Jafethit, edhe atij i lintnë bij.
- 22 Të bijt' e Shimit ishinë Ellami, e Asshuri, e Arfakshadi, e Lludi, e Arami.
- 23 Edhe të bijt' e Aramit ishinë Uzi, e Ulli, e Gjetheri, e Mashi.

- 24 Edhe Arfakshadit i lindi Shellau; edhe
25 Shellaut i lindi Eberi. Edhe Eberit i lintnë dy
bij; emëri i njërit ishte Falek; sepse ndë ditt'
t' atij unda dheu; edhe emëri i të vëllajt t' atij
26 ishte Joktan. Edhe Joktanit i lindi Allmodadi,
27 e Shalefi, e Hasarmavethi, e Jarahu, E Adora-
28 mi, e Uzalli, e Dikllau, E Oballi, e Abimaili,
29 e Shevaj, E Ofiri, e Avillahu, e Jobabi; këta
30 të-gjithë ishinë të bijt' e Jokatit. Edhe të-
ndënjurit' e atyre ishte nga Mishaja, kur ve-
te njeriu për ndë Shefar, malin' e të-lindurit
të djellit.
- 31 Këta ishinë të bijt' e Shimit, pas faravet
të tyre, pas gjuhëravet të tyre, ndë vëndet të
tyre, pas kombevet të tyre.
- 32 Këto janë farat' e të bijvet të Noesë, pas
brezavet të tyre, ndë kombet të tyre; edhe
nga këta upërndanë kombetë pas përmbytjesë.